



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.246/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën koalicionit PDK-AAK-NISMA, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike-rrugë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Mitrovicë, kështu që Koalicionit LDK-AKR, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3,000.00 (tremijë euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 13.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, të dorëzuar nëpërmjet postes me datën 01.06.2017 në të cilën pretendohet se në rrugën “Afrim Zhitia”, rrugën “Mbretëresha Teutë” dhe në tunelin e parë në Mitrovicë, aktivisti tyre ka vërejtur se Koalicioni LDK-AKR. ka vendosur postere të kandidatëve të tyre për deputet në hapësira publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e Koalicioni LDK-AKR, është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 par. 1 pika b të LZP-së në Republikën e Kosovës, lidhur me këto shkelje parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 7 fotografi si deshmi.

PZAP-i i dërgoi koalicionit LDK-AKR, Urdhër për Përmirësim me qëllim të evitimit të shkeljes, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje nga koalicioni në afatin e përcaktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e Koalicionit LDK-AKR janë vendosur në hapësirë publike- mbi rrugë publike dhe tek tuneli veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e koalicionit LDK-AKR, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posterët e kandidatëve për deputet nga koalicioni LDK-AKR janë vendosur mbi rrugë publike dhe tunel.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit LDK-AKR, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është e përsëritur disa herë gjatë këtij procesi zgjedhor, dhe faktin se posterat e kandidatëve për deputet nga ky koalicion janë vendosur mbi rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që se koalicionit në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur brenda afatit të caktuar mirëpo PZAP-i nuk ka pranuar nga ana e tyre përgjigje se kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes për të tërhequr posterat nga vendet e palejuara, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.246/2017 më datën 13.06.2017.

**Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.